



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

VENDIM

Nr. 17 datë 06.06.2026



PËR “MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026–2030”.

Në mbështetje të nenit 24, pika 1 dhe nenit 54, pika “k” të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 64/2025, datë 06.11.2025 “Për barazinë gjinore”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe planit të saj të veprimit”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjit nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”; Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar; Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, të nënshkruar nga Bashkia Gjirokastrë; si dhe dokumentit “Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030”, Këshilli Bashkiak Gjirokastrë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të ngarkojë të gjitha drejtoritë, strukturat administrative dhe institucionet në varësi të Bashkisë Gjirokastrë për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në plan.
3. Drejtoria e Financës të parashikojë fondet përkatëse në programet buxhetore afatmesme dhe vjetore, në përputhje me objektivat e planit.
4. Agjencia e Shërbimit Social dhe Shëndetësor, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të koordinojë monitorimin dhe raportimin periodik të zbatimit të planit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Bexhet BAXHELLA

KRYETARË E KËSHILLIT
Merita ISARAJ

